

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo	 PRISHTINA
	Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	

Datë/a:	07.09.2020
Për/ Za/ To:	“BOTEK” sh.p.k.;
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesave

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 02.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “BOTEK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 20 012 111** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet në tërësi si e pa bazuar** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik:
2. “BOTEK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 20 012 111**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK –së, të datës 28.08.2020 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së. të publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
3. Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin e marrur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 20 012 111**.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 28.08.2020 ka bërë Njoftimit mbi vendimin e AK –së lidhur me me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 20 012 111**.

Operatori Ekonomik: “BOTEK” sh.p.k.; kanë bërë kërkesë për çasje në dokumente zyrtare të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Me datë: 02.09.2020, **Operator Ekonomik:** “BOTEK” sh.p.k.; ka bërë kërkesë për rishqyrtim me c’rast pretendimet e tyre i kanë mbështetur si në vijim:

Pasi që zyrtarisht kemi kërkuas çasje në dokumentet e OE të propozuara për kontratë me datë 31.08.2020 kemi Rishikuaa Dosjen / Ofertën Teknike të OE ARITECH shpk & Cimi “Electronic shpk dhe kemi konstatuaa ndër të tjera këto mos përmbushje të kërkesave të dosjes së tenderit nga ana e këtij grupi të OE:

Pika 1. Për Pozicionin 2. në dosjen e tenderit është kërkuar KOMPJUTER Brand Name - Mid Tower qe ky kompjuterë të ketë; SSD- 500GB, HDD-500 GB dhe Lexuesi optik - DVD Drive.

Për këtë pozicion OE ARITECH shpk & Cimi “Electronic shpk ka dorëzuar broshurën nga Prodhuesi HP për Kompjuter HP Desktop Pro G3 ku shihet çart ne broshure (faqen2) që ky Modeli i PC, i konfirmuar nga vete prodhuesi HP, nuk mundet me ofruar konfigurimin e kombinuar për Drives; SSD: 500 GB dhe HDD: 500 GB si dhe Lexuesi optik: DVD Drive, siç është kërkuar ne dosjen e tenderit.

Prova 1: Për ta vërtetuar këtë fakt, ju lutem e gjeni te bashkangjitur broshurën e dorëzuar nga vete OE, “Broshurat - Pjesa 2 - PC dhe Monitor” konkretisht ne faqen 2 të broshurës ku shkruan qartësisht “KUJDES” si ne vijim:

Note: Following configurations are supported:

- a) 3.5" internal storage & 9.5mm optical drive
- b) 2.5" internal storage & 9.5mm optical drive
- c) 3.5" internal storage & 2.5" internal storage
- d) 2.5" internal storage & 2.5" internal storage

Duke u bazuar në këtë konfirmim nga broshura e prodhuesit, AK do të duhej qe ta merrte parasysh këtë fakt dhe OE ARITECH shpk & Cimi “Electronic shpk, të shpallej i papërgjegjshëm teknikisht.

Pika 2. Në dosjen e tenderit gjatë procedurës së sqarimeve shtesë te datës 13.04.2020,

është qartësuar nga ana e AK- se, OE duhet te ofertojnë edhe mbajtës të TV i cili duhet t'i ketë këto specifika teknike:

Përgjigja për OE:

Mbajtësi duhet:

- Të jetë statik/i palëvizshëm dhe i përshtatshëm për vendosjen horizontale te TVse ne muret e klasave.

- Të jetë nga materiali i forte dhe rezistent ne rastet kur ndoshta mund te tërhiqet me force nga nxënësit.

- Të përkrah peshën e TVsë te specifikuar ne katalogun e prodhuesit.

- Të ketë hapësirën e nevojshme për shfrytëzimin e porteve dhe funksioneve tjera mbrapa TVse te kërkuara ne specifika.

- Të ngjitet me bulona te forte dhe mire ne mur, me c'rast TV do të sigurohet nga dëmtimi i mundshëm fizik si pasoje e shkaqeve te lartcekura.

Për këtë pozicion, OE ARITECH shpk & Cimi "Electronic shpk, në ofertën e tyre NUK ka dorëzuar fare Broshurën për mbajtësin e TV si dhe NUK ka specifikuar fare modelin dhe specifikat e mbajtësit të TV, në mënyrë që ju si AK të keni mundësi ta vërtetoni që mbajtësi për TV i përmbush te gjitha specifikat e kërkuara. Mungesa e broshurës dhe mos specifikimit i modelit te sakte te mbajtësit krijon mundësin e manipulimit gjatë procedurës te pranim dorëzimit, duke dorëzuar mbajtës jo kualitativ qe nuk përmbush specifikat e kërkuara

Prova 2. - "Përgjigjet për OE lidhur me kërkesat për sqarim_13.04.2020", pra, duke pasur parasysh kërkesat e AK gjatë sqarimeve shtese ku definohet ne detaje kualiteti i Mbajtësit të TV me te gjitha aspekte teknike, dhe ku është kërkuar qe mbajtësi duhet "Të përkrah peshën e TVsë te specifikuar ne katalogun e prodhuesit" nënkupton që OE do të duhej të dorëzojnë edhe broshurën e prodhuesit të mbajtësit të ofertuar, ku përfshihen te specifikat teknike te kërkuara.

Mos specifikimi i modelit të ofertuar të mbajtësit për TV nga ana e këtyre OE, ka pasur dhe ka efekte te konsiderueshme financiare dhe materiale gjatë ofertimit dhe rrjedhimisht as përmes çfarëdo sqarimi të tenderit nuk lejohet të shtohet ose ndryshohet oferta teknike apo financiare

Pika 3. Në dosjen e tenderit gjatë procedurës së Sqarimeve shtesë "Sqarime shtese per OE_04.05.2020", është qartësuar nga ana e AK se qe OE duhet të ofertoj Keyboard për TV i cili duhet t'i plotësoj specifikat si në vijim:

"Nuk kërkohet të ketë touchpad por pranohet edhe me touchpad (sqarim: kërkesa është për TV keyboard dhe jo për PC keyboard) dhe nuk kërkohet MAF/DAF i veçantë për këtë Keyboard, kërkohet vetëm kualiteti dhe te jete e prodhuar nga një brend i njohur nderkomtare ashtu siç është kërkuar edhe ne specifika për te gjitha pajisjet tjera"

Për këtë kërkesë të AK, OE ARITECH shpk & Cimi "Electronic shpk, në ofertën e tyre teknike NUK kanë dorëzuar fare Broshurën dhe NUK e kanë specifikuar fare modelin e Keyboardit për TV, ashtu sikurse është kërkuar nga AK ne sqarime shtesë, "qe ky Keyboard te jete për TV dhe jo Desktop dhe te jete kualitet dhe te jete e prodhuar nga një brend i njohur ndërkombëtar"

Rrjedhimisht OE ARITECH shpk & Cimi "Electronic shpk duke mos specifikuar modelin e Keyboardit për TV ashtu sikurse është kërkuar gjatë procedurës së Sqarimeve shtesë, është i papërgjegjshëm dhe në këtë mënyrë krijohet mundësia e manipulimit gjatë procedurës së dorëzimit të pajisjeve duke dorëzuar Keyboard për TV jo kualitativ dhe jo brand ndërkombëtar.

OE ARITECH shpk & Cimi "Electronic shpk në ofertën e tyre pra, NUK ka dorëzuar fare Broshurën për Keyboard e TV si dhe NUK ka specifikuar fare modelin dhe specifikat e Keyboardit për TV, në mënyrë që ju si AK të keni mundësi ta vërtetoni që Keyboardi për TV i përmbush të gjitha specifikat e kërkuara.

Mos specifikimi i modelit të ofertuar të Keyboardit për TV ka pasur efekte te konsiderueshme financiare dhe materiale gjate përgatitjes së ofertës dhe rrjedhimisht as përmes cfarëdo sqarimi të tenderit nuk lejohet të shtohet ose ndryshohet materiali

Baza Ligjore

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës në pretendimin e OE - ankimor se Operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk përmbush katalogun e ofertuar sipas specifikimeve teknike konstaton se nuk qëndron për faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar katalogun me ofertë sipas specifikimeve teknike ku jashtëzakonisht mirë është e sqaruar në linqet zyrtare të website të prodhuesve të këtyre pajisjeve, me ç'rast përmbushin specifikacionet në mënyrë të saktë sipas përshkrimit të çmimit në paramasë.

Provë 1: linqet zyrtare të katalogjeve

<http://h20195.www2.hp.com/v2/getpdf.aspx/c06182356.pdf> - Laptop

<http://h20195.www2.hp.com/v2/getpdf.aspx/c06461731.pdf> - Shtëpiza

<http://h20195.www2.hp.com/v2/GetDocument.aspx/docname=c05943579> -
monitor

https://www.philips.ie/c-p/75PUS7354_12/7300-series-4k-uhd-led-andorid-tv-with-ambilight-3-sided#see-all-benefits - ANDROID TV

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

A handwritten signature in blue ink, consisting of a series of loops and flourishes, positioned above a solid horizontal line.